




KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

**Indeksi i transparencës
proaktive të njësive të
vetëqeverisjes vendore për vitin**

2025

www.idp.al

INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE I NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE (NJVV) PËR VITIN 2025

Përmbajtja

HYRJE	2
METODOLOGJIA.....	5
MONITORIMI I NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE.....	8
GJETJET E “INDEKSIT TË TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE PËR VITIN 2025”	16

HYRJE

Transparenca proaktive do të thotë që institucionet publikojnë informacionin e tyre rregullisht dhe në mënyrë të përditësuar. Kjo u jep qytetarëve mundësinë të dinë çfarë bëjnë autoritetet publike (në vijim “AP”) dhe të ndjekin veprimtarinë e tyre. Publikimi i informacionit i bën institucionet më përgjegjëse dhe të besueshme. Për këtë qëllim, vjen në ndihmë një instrument mjaft i rëndësishëm ligjor dhe konkretisht “*Programi i Transparencës*”.

Programi i Transparencës është një instrument kyç i transparencës proaktive, i cili garanton aksesin e publikut në informacion dhe dokumente me interes publik, redukton nevojën për paraqitjen e kërkesave individuale për informacion dhe forcon llogaridhënien institucionale.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka kryer për të gjashtin vit rradhazi monitorimin e transparencës proaktive të autoriteteve publike njësi të vetëqeverisjes vendore, ku përfshihen 61 (*gjatëdhjetë e një*) bashki dhe 12 (*dymbëdhjetë*) këshilla qarqesh.

Ky monitorim i kryer nga Zyra e Komisionerit sjell fotografimin e gjendjes në një moment të caktuar të publikimit të informacionit nga ana e autoriteteve publike. Ai përfshin kontrollin e faqeve zyrtare të institucioneve dhe Programin e Transparencës. Kështu, bëhet vlerësimi në mënyrë të paanshme nëse institucionet publikojnë informacionin e tyre rregullisht dhe në përputhje me ligjin. Rezultatet e monitorimit tregojnë sa të përgjegjshme dhe sa të hapura janë autoritetet publike. Ky proces ndihmon qytetarët, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile të dinë më shumë për veprimtarinë e institucioneve dhe të kërkojnë llogaridhënie kur është e nevojshme.

Gjithashtu, monitorimi nxjerr në pah praktikat më të mira dhe sfidat që kanë institucionet në zbatimin e transparencës proaktive. Kjo shërben si udhërrëfyes për përmirësim dhe siguron që informacioni të jetë i lehtë për t’u gjetur dhe i kuptueshëm.

Ky monitorim dhe hartimi i “*Indeksit të transparencës proaktive të njërive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2025*” (në vijim “*Indeksi NJVV 2025*”) është kryer duke marrë në konsideratë standardet e përcaktuara në Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e programit të transparencës të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore” (në vijim “*Urdhri nr. 211/2018*”), të cilit i janë nënshtruar 61 bashkitë dhe Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar”, i ndryshuar (në vijim “*Urdhri nr. 187/2020*”), të cilit i janë nënshtruar 12 këshillat e qarqeve. Qëllimi i Programit të Transparencës është garantimi i aksesit sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirës në informacionin/dokumentacionin me karakter publik dhe kjo qasje ka ndikim të

drejtpërdrejtë në rritjen e llogaridhënies si brenda strukturës hierarkike të AP, ashtu, dhe më e rëndësishmja, përballë qytetarëve apo grupeve të interesit. *Indeksi NjVV 2025* nga pikëpamja strukturore është i njëjtë me atë të viteve të kaluara, por më i zgjeruar për arsye se janë shtuar 4 (katër) tregues, duke e çuar numrin e tyre në 16 (qjashtëmbëdhjetë) dhe do të trajtohet gjerësisht më poshtë në seksionin e Metodologjisë.

Tabela 1: Kategoritë e informacionit në Programin e Transparencës sipas Urdhri nr. 211/2018.





Tabela 2: Kategoritë e informacionit në Programin e Transparencës sipas Urdhri nr. 187/2020



Nga praktika e deritanishme e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga Zyra e Komisionerit, modelet ekzistuese të urdhrave nr. 211/2018 dhe nr. 187/2020 kanë rezultuar të suksesshme në mënyrën e organizimit dhe përmbajtjes së rubrikave/nënrubrikave, duke ndikuar pozitivisht në thjeshtësinë dhe lehtësinë e përdorimit të tyre. Kjo praktikë e mirë dhe e konsoliduar ndër vite, ka shërbyer që Programit të Transparencës t'i bëhen disa shtesa dhe ndryshime që nuk ndryshojnë thelbin e përmbajtjes së modelit ekzistues, por synojnë që këtë përvojë pozitive në zbatimin e tij ta forcojnë akoma edhe më shumë. Për sa më sipër, në zbatim të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale doli me Urdhrin nr. 281, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”¹, standardet e të cilit do të monitorohen prej vitit 2026 e në vijim. Këtij Urdhri i nënshtrohen të gjitha bashkitë dhe këshillat e qarqeve.

¹<https://idp.al/wp-content/uploads/2026/01/Urdher-nr.-281-miratimi-Programi-model-i-transparences-per-Njesite-e-Veteqeverisjes-Vendore.pdf>

METODOLOGJIA

Zyra e Komisionerit ka krijuar një traditë të konsoliduar në përlllogaritjen e renditjes në “Indekset” e kaluara, sistemim i cili edhe për vitin 2025 është parimisht i njëjti, por i pasuruar edhe me 4 (katër) tregues të rinj duke e çuar totalin e tyre në 16 (gjashtëmbëdhjetë). Sipas kësaj metodologjie, vjen gjithnjë e më shumë në përmirësim procesi i monitorimit të AP për zbatimin e parashikimeve të nenit 7 të LDI, ku është përcaktuar qartë natyra, lloji dhe sasia e informacionit/dokumentacionit që duhet bërë publik pa kërkesë.

Tabela 3: Treguesit e monitorimit të NJVV 2025

Treguesi i parë:	<i>Publikimi i Programit të Transparencës</i>	Treguesi i nëntë:	<i>Koordinatori për të drejtën e informimit</i>
Treguesi i dytë:	<i>Struktura/Organigrama</i>	Treguesi i dhjetë:	<i>Raporte monitorimi/auditimi KLSH</i>
Treguesi i tretë:	<i>Struktura e pagave</i>	Treguesi i njëmbëdhjetë:	<i>PBA 2025- 2027/Buxheti 2025</i>
Treguesi i katërt:	<i>Funksionet e NJVV</i>	Treguesi i dymbëdhjetë:	<i>Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8-mujor 2025</i>
Treguesi i pestë:	<i>Publikimi i vendimeve të NJVV</i>	Treguesi i trembëdhjetë:	<i>Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025</i>
Treguesi i gjashtë:	<i>CV e titullarit</i>	Treguesi i katërmëdhjetë²:	<i>Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025</i>
Treguesi i shtatë:	<i>Legjislacion kombëtar</i>	Treguesi i pesëmbëdhjetë:	<i>Lista e shërbimeve që ofron NJVV</i>
Treguesi i tetë:	<i>Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizmin e NJVV</i>	Treguesi i gjashtëmbëdhjetë:	<i>Publikimi i informacionit mbi “Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik”</i>

²Do të shënohen me *“Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve” përcjellë me e-mail pranë Zyrës së Komisionerit.

Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 16 treguesve kryesorë, të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore. Numri total i pikëve të vlerësimit të treguesve është 16 (gjashtëmbëdhjetë). Bazuar në pikëzimin e çdo treguesi llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilën bashki dhe këshillë qarku.

Instrumenti kryesor për matjen e transparencës proaktive është publikimi i Programit model të Transparencës në faqen zyrtare të NjVV. Sistemi i matjes i përdorur në këtë metodologji është i thjeshtë dhe lejon një vlerësim të shpejtë të treguesve, bazuar në gjendjen reale të tyre në momentin e kërimit në faqen zyrtare të internetit, duke krijuar mundësinë e procesimit të menjëhershëm për shkak të lehtësisë së përdorimit dhe shpejtësisë, në arritjen e përfundimeve në lidhje me përcaktimin e nivelit të transparencës.

Ky sistem me 16 tregues ka si qëllim matjen dhe raportimin periodik të transparencës për secilën bashki/këshill qarku dhe i shërben Zyrës së Komisionerit si bazë për të monitoruar nivelin funksional të saj për evidentimin e progresit, pikat e dobëta dhe të forta të tij. Njëkohësisht, ky pikëzim i referohet dhe është i ngjashëm me sistemin e matjes së transparencës së NjVV i përdorur dhe në vitet parardhëse, të cilat i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit në lidhjen: <https://idp.al/raporte-monitorimi/>.

Sistemi i matjes së treguesve vazhdon të jetë i njëjti si ai i periudhës paraardhëse, ndërkohë, që përllogaritja e treguesve është vendosur të kryhet me 3 nivele:

-  **0** pikë në rast se informacioni nuk është publikuar;
-  **0,5** pikë kur informacioni është publikuar pjesërisht dhe;
-  **1** pikë kur informacioni është i publikuar plotësisht.

Pas monitorimit të çdo bashkie dhe këshilli qarku për 16 kategoritë e mësipërme, numri i pikëve u mbledh për secilën prej tyre dhe hartua renditja në “Indeks” duke filluar nga autoriteti publik i cili ka grumbulluar më shumë pikë, duke zbritur deri tek autoriteti publik me numrin më të ulët të tyre.

Duke respektuar traditën e konsoliduar të kësaj metodologjie, në kombinim të këtyre dy kritereve, sipas pikëzimit individual AP janë grupuar në kategoritë e mëposhtme:

- ✓ me transparencë proaktive të lartë, kanë grumbulluar **13-16** pikë dhe janë shënuar me ngjyrë të gjelbër;
- ✓ me transparencë proaktive mesatare, kanë grumbulluar **9-12.5** pikë dhe janë shënuar me ngjyrë të bardhë;

- ✓ me transparencë proaktive të ulët, kanë grumbulluar 5-8.5 pikë dhe janë shënuar me ngjyrë të verdhë;
- ✓ me transparencë proaktive minimale kanë grumbulluar 0-4.5 pikë dhe janë shënuar me ngjyrë të kuqe.

Nëpërmjet kësaj metodologjie, monitorimi dhe hartimi i *Indeksit NjVV 2025* nga Zyra e Komsionerit ndjek parimet e matjes dhe të krahasueshmërisë së evoluimit të transparencës proaktive, duke patur si objektiv parësor cilësinë e informacionit/dokumentacionit që publikohet në Programin e Transparencës nga secili autoritet publik. Ky vlerësim fotografon situatën aktuale, por njëkohësisht shërben edhe si udhërrëfyes për të programuar veprimet e mëtejshme procedurale të institucionit përsa i përket rolit dhe përgjegjësisë në zbatimin e parashikimeve ligjore nga çdo zyrtar.

MONITORIMI I NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Zyra e Komisionerit në përfundim të këtij procesi dhe në hartimin e *Indeksit NjVV 2025* ka vijuar të ndjekë parimin e rendit zbritës: nga pikëzimi maksimal në atë minimal, në mënyrë që përdorimi i këtij dokumenti të jetë sa më i kuptueshëm dhe i thjeshtë. Po ashtu, duhet theksuar, se renditja e autoriteteve publike me të njëjtin numër pikësh është bërë sipas rendit alfabetik.

Nr.	NjVV	Publikimi i Programit të Transparencës	Struktura/Organigrama	Struktura e pagave	Funksionet e NjVV	Publikimi i vendimeve të NjVV	CV e titullarit	Legjislacion kombëtar	Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizimin e NjVV	Koordinatori për të drejtën e informimit	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	PBA 2025-2027/Buxheti 2025	Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8-mujor 2025	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025	Lista e shërbimeve që ofron NjVV	Publikimi i informacionit mbi “ Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik”	Nr. total i pikëve
1	Bashkia Divjakë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	16
2	Bashkia Klos	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	16
3	Bashkia Mirditë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	16
4	Bashkia Patos	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	16
5	Bashkia Shijak	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	16
6	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	15.5
7	Këshilli Qarkut Lezhë	1	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	15.5

Nr.	NjVV	Publikimi i Programit të Transparencës	Struktura/Organigrama	Struktura e pagave	Funksionet e NjVV	Publikimi i vendimeve të NjVV	CV e titullarit	Legjislacion kombëtar	Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizimin e NjVV	Koordinatori për të drejtën e informimit	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	PBA 2025-2027/Buxheti 2025	Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8-mujor 2025	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025	Lista e shërbimeve që ofron NjVV	Publikimi i informacionit mbi “ Të dhënat e koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik”	Nr. total i pikëve
8	Bashkia Dropull	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	15
9	Bashkia Kukës	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	15
10	Bashkia Lezhë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	15
11	Bashkia Pegin	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	15
12	Bashkia Roskovec	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1	15
13	Bashkia Kamëz	1	1	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	0	1	1	1	14.5
14	Bashkia Mat	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	14.5
15	Bashkia Përmet	1	1	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	0	1	1	1	14.5
16	Bashkia Tiranë	1	0.5	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	14.5
17	Bashkia Belsh	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	0	1	1	1	1	14
18	Bashkia Bulqizë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	0	1	1	1	1	14

Nr.	NjVV	Publikimi i Programit të Transparencës	Struktura/Organigrama	Struktura e pagave	Funksionet e NjVV	Publikimi i vendimeve të NjVV	CV e titullarit	Legjislacion kombëtar	Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizimin e NjVV	Koordinatori për të drejtën e informimit	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	PBA 2025-2027/Buxheti 2025	Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8-mujor 2025	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025	Lista e shërbimeve që ofron NjVV	Publikimi i informacionit mbi “ Të dhënat e koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik”	Nr. total i pikëve
19	Këshilli i Qarkut Vlorë	1	1	1	1	0	1	1	1	1	0	1	1	1	1	1	1	14
20	Bashkia Berat	1	1	1	1	1	1	0.5	1	1	0	1	1	0	1	1	1	13.5
21	Bashkia Devoll	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	0	13.5
22	Bashkia Lushnje	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	0	1	0.5	1	13.5
23	Bashkia Prrenjas	1	0.5	0	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	13.5
24	Bashkia Selenice	1	1	1	1	1	0	0.5	1	1	1	1	1	0	1	1	1	13.5
25	Këshilli i Qarkut Durrës	1	1	1	1	0	0.5	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	13.5
26	Bashkia Kucovë	1	1	1	0	1	1	1	1	1	0	1	1	0	1	1	1	13
27	Bashkia Shkodër	1	1	1	0.5	1	1	0.5	1	1	1	1	1	0	1	1	0	13
28	Bashkia Skrapar	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	0	0	1*	1	1	13*

Nr.	NjVV	Publikimi i Programit të Transparencës	Struktura/Organigrama	Struktura e pagave	Funksionet e NjVV	Publikimi i vendimeve të NjVV	CV e titullarit	Legjislacion kombëtar	Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizimin e NjVV	Koordinatori për të drejtën e informimit	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	PBA 2025-2027/Buxheti 2025	Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8-mujor 2025	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025	Lista e shërbimeve që ofron NjVV	Publikimi i informacionit mbi “ Të dhënat e koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik”	Nr. total i pikëve
29	Bashkia Dibër	1	1	1	1	1	0	0.5	1	1	1	1	0	0	1	1	1	12.5
30	Bashkia Has	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	0	0	1	0.5	1	12.5
31	Bashkia Malësia e Madhe	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	0	0	0.5	1	1	12.5
32	Këshilli i Qarkut Berat	1	1	1	1	0.5	0	1	1	1	0	1	1	1	1	1	0	12.5
33	Bashkia Delvinë	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1	0	0	0	1	1	1	12
34	Bashkia Finiq	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1	0	0	0	1	1	1	12
35	Bashkia Konispol	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	0	0	1	0	1	12
36	Bashkia Gramsh	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	0	0	1	0	1	12
37	Bashkia Vau Dejes	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	0	0	0	1	1	1	12
38	Bashkia Vlorë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	0	0	0	1	1	1	12

Nr.	NjVV	Publikimi i Programit të Transparencës	Struktura/Organigrama	Struktura e pagave	Funksionet e NjVV	Publikimi i vendimeve të NjVV	CV e titullarit	Legjislacion kombëtar	Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizimin e NjVV	Koordinatori për të drejtën e informimit	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	PBA 2025-2027/Buxheti 2025	Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8-mujor 2025	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025	Lista e shërbimeve që ofron NjVV	Publikimi i informacionit mbi “ Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik”	Nr. total i pikëve
39	Këshilli i Qarkut Korçë	1	1	1	1	0.5	1	1	0	1	0	1	0.5	1	1	1	0	12
40	Këshilli i Qarkut Shkodër	1	1	1	1	0.5	0.5	1	1	1	0	1	0	1	1	1	0	12
41	Këshilli i Qarkut Tiranë	1	1	1	1	0.5	1	0.5	1	1	0	1	1	0	1	1	0	12
42	Bashkia Himarë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	0	0	0	1	0.5	1	11.5
43	Bashkia Kolonjë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	0	0	0.5	0	1	11.5
44	Bashkia Polican	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	0	0	0.5	0	1	11.5
45	Bashkia Vorë	1	1	0	1	1	1	1	1	1	0	1	0	0	1	0.5	1	11.5
46	Bashkia Libohovë	1	1	1	1	1	1	1	0	1	0	0	0	0	1	1	1	11
47	Bashkia Maliq	1	1	1	0	1	1	1	0	1	1	1	0	0	1	0	1	11
48	Bashkia Pogradec	1	0	0	1	1	0	1	0	1	0	1	1	1	1	1	1	11


Nr.	NjVV	Publikimi i Programit të Transparencës	Struktura/Organigrama	Struktura e pagave	Funksionet e NjVV	Publikimi i vendimeve të NjVV	CV e titullarit	Legjislacion kombëtar	Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizimin e NjVV	Koordinatori për të drejtën e informimit	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	PBA 2025-2027/Buxheti 2025	Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8-mujor 2025	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025	Lista e shërbimeve që ofron NjVV	Publikimi i informacionit mbi “ Të dhënat e koordinitorit për njoftimin dhe konsultimin publik”	Nr. total i pikëve
49	Bashkia Pustec	1	1	1	1	1	0	1	0	1	1	1	0	1	1	0	0	11
50	Bashkia Tropojë	1	1	1	0	1	1	1	1	1	0	1	0	0	1	1	0	11
51	Bashkia Korçë	1	1	1	1	1	1	0.5	0	1	0	1	0	0	1	0	1	10.5
52	Bashkia Sarandë	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	0	0	0	1	0.5	0	10.5
53	Këshilli i Qarkut Fier	1	1	1	1	0	1	0.5	1	1	1	0	0	0	1	1	0	10.5
54	Bashkia Kurbin	1	1	0	1	1	1	1	1	1	0	1	0	0	0.5*	0	1	10.5*
55	Bashkia Cerrik	1	1	1	1	1	0	0.5	1	1	1	0	0	0	1	0.5	0	10
56	Bashkia Mallakastër	1	1	1	1	1	0	1	1	1	0	0	0	0	1	0	1	10
57	Këshilli i Qarkut Kukës	1	1	1	1	0.5	0	0.5	0	1	0	1	0.5	0.5	1	1	0	10
58	Bashkia Librazhd	1	1	0	0.5	1	1	1	1	1	0	1	0	0	1	0	0	9.5
59	Bashkia Rrogozhinë	1	0.5	0	0	1	1	1	1	1	0	0	0	0	1	1	1	9.5

Nr.	NjVV	Publikimi i Programit të Transparencës	Struktura/Organigrama	Struktura e pagave	Funksionet e NjVV	Publikimi i vendimeve të NjVV	CV e titullarit	Legjislacion kombëtar	Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizimin e NjVV	Koordinatori për të drejtën e informimit	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	PBA 2025-2027/Buxheti 2025	Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8-mujor 2025	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025	Lista e shërbimeve që ofron NjVV	Publikimi i informacionit mbi “ Të dhënat e koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik”	Nr. total i pikëve
60	Këshilli i Qarkut Elbasan	1	1	1	1	0.5	1	0	1	1	1	0	0	0	1	0	0	9.5
61	Bashkia Elbasan	1	0.5	0	1	1	1	1	0	1	0	1	1	0	0.5	0	0	9
62	Bashkia Durrës	1	0.5	0	0	1	1	1	1	1	0	1	0	0	1	0	0	8.5
63	Bashkia Pukë	1	1	1	0.5	0	1	0	0	1	0	1	0	0	1	1	0	8.5
64	Bashkia Fier	1	0.5	0	1	1	1	0	0	1	0	1	0	0	0.5	0	1	8
65	Bashkia Krujë	1	1	1	0	0	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0	1	8
66	Këshilli i Qarkut Dibër	1	1	1	0	0.5	0	0	1	1	0	0	0	0	1	1	0	7.5
67	Bashkia Tepelenë	1	0	0	1	1	0	0.5	0	1	0	1	0	0	1	0	0	6.5

Nr.	NjVV	Publikimi i Programit të Transparencës	Struktura/Organigrama	Struktura e pagave	Funksionet e NjVV	Publikimi i vendimeve të NjVV	CV e titullarit	Legjislacion kombëtar	Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizimin e NjVV	Koordinatori për të drejtën e informimit	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	PBA 2025-2027/Buxheti 2025	Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8-mujor 2025	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025	Lista e shërbimeve që ofron NjVV	Publikimi i informacionit mbi “ Të dhënat e koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik”	Nr. total i pikëve
68	Bashkia Këlcyrë	1	1	0	0	0	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0	6
69	Bashkia Gjirokastrë	1	1	0	1	0	0	0	1	1*	0	0	0	0	0	1	0	6*
70	Bashkia Kavajë	1	0	0	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	1*	0	0	4*
71	Bashkia Dimal	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0.5	0	0	2.5
72	Bashkia Fushë Arrëz	0	0	0	0	1	0	0	0	1*	0	0	0	0	0	0	0	2*
73	Bashkia Memaliaj	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	1*	0	0	2*

GJETJET E “INDEKSIT TË TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE PËR VITIN 2025”

Në përfundim të monitorimit të kryer rezultojnë se:



28 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “transparencë proaktive të lartë” (semafor i gjelbër) ose 38%.

33 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “transparencë proaktive mesatare” (semafor i bardhë) ose 45%.

8 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “transparencë proaktive të ulët” (semafor i verdhë) ose 11%.

4 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “transparencë proaktive minimale” (semafor i kuq) ose 6%.

Nga krahasimi i të dhënave të “Indeksit NjVV 2025” me atë të vitit 2024, Zyra e Komisionerit konstaton se ka një rënie të lehtë të autoriteteve publike të kategorizuara me transparencë proaktive të lartë nga 30 në **28** (-2 NjVV). Nga ana tjetër, vihet re se ka një rritje të kategorisë së atyre të listuara me transparencë proaktive mesatare nga 30 në **33** (+3 NjVV), ndërkohë që për për grupin e institucioneve që janë kategorizuar me transparencë proaktive të ulët kemi një zbritje të numrit të tyre nga 13 në **8** (-5 NjVV), ndërsa, në kategorinë e fundit, me transparencë proaktive minimale, shifrat flasin për një rritje nga 0 në **4** (+4 NjVV).

Rënia e lehtë e numrit të autoriteteve publike në kategoritë e grupuara në dy ngjyrat e sipërme të semaforit të transparencës proaktive lidhet kryesisht me rritjen e kërkesave dhe kriterëve të vlerësimit në *Indeksin NjVV 2025*, si dhe me nevojën për përditësim të vazhdueshëm të informacionit të publikuar. Disa autoritete publike, megjithëse kanë ruajtur praktika të mira transparence, nuk kanë reflektuar në kohë përditësimet e nevojshme në Programin e Transparencës ose në faqet e tyre zyrtare. Nga ana tjetër, rritja e autoriteteve të kategorizuara me transparencë minimale tregon se mungesa e qëndrueshmërisë institucionale, ndryshimet strukturore apo administrative, si dhe mosndjekja sistematike e detyrimeve ligjore, ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e transparencës proaktive.

Këto rezultate evidentojnë faktin se transparenca nuk është një veprim i njëhershëm, por kërkon angazhim të vazhdueshëm, dinamik dhe përgjegjësi institucionale. Megjithatë, *Indeksi NjVV 2025* dëshmon një përmirësim cilësor të transparencës proaktive në fashën e parë të semaforit, duke treguar se autoritetet me performancë të lartë po konsolidojnë praktikatat e tyre dhe po i afrohen standardeve më të larta të transparencës proaktive.

Duke marrë në konsideratë rritjen e numrit të treguesve të vlerësimit në *Indeksin NjVV 2025* krahasuar me atë të vitit 2024, *Zyra e Komisionerit* vlerëson se, në tërësi, transparenca proaktive ka shënuar përmirësim, edhe pse mund të konstatohen ndryshime fare të vogla të vlerave nominale që korespondojnë me të kategorizimin në grupe të *NjVV*. Megjithatë, mbetet e nevojshme rritja e angazhimit institucional dhe forcimi i përgjegjshmërisë profesionale për adresimin e sfidave dhe problematikave të evidentuara. Në këtë kuadër, *Zyra e Komisionerit* mirëpret çdo mbështetje teknike, financiare apo në ngritjen e kapaciteteve, si nga organizatat e shoqërisë civile, ashtu edhe përmes alokimeve nga buxheti i shtetit, me qëllim forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të instrumentit të Programit të Transparencës.